

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	17 vite pas ek*ekutimit të Franc Konomit, familja rrëfen atentatet dhe konfliktin për pasurinë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/17-vite-pas-ekzekutimit-te-franc-konomit-familja-rrefen-atentatet-dhe-konfliktin-per-pasurine/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:23:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:22:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	523464d5f851855b0011a8bad125d131a59f87787fce6467db9963fcf6c06258
TEKSTI	10eb21874409b60e49619da58ac2e37a89c1cedd6fb115f7aae0234ede66b1a4
PAMJA	2645942d7a0c1f9c1e54a5f5f7065d0e36697d6dc545521f53cfb9bda5b9190a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5baa19ef3a6e0023c89a7ec70b2e657103c279d1560ecb39d69729852341c973
E MËPARSHMJA	ffa11f3b44adcd0aa358db5a0754119e21ac94f47db6d3f0333515e6628e2125
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5baa19ef3a6e0023c89a7ec70b2e657103c279d1560ecb39d69729852341c973>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » 17 vite pas ek*ekutimit të Franc Konomit, familja rrëfen atentatet dhe konfliktin për pasurinë

AKTUALITET

Demo

17 vite pas ek*ekutimit të Franc Konomit, familja rrëfen atentatet dhe konfliktin për pasurinë

SEPTEMBER 14, 2026



Vrasja e Franc Konomit, një prej ngjarjeve më të bujshme kriminale të viteve të fundit në Shqipëri, është rikthyer në vëmendje përmes rrëfimit të familjarëve të tij. Djali i tij, Xhoni, dhe bashkëshortja, Roven, kanë folur për herë të parë publikisht për dhimbjen e humbjes, pretendimet për atentate ndaj djalit dhe konfliktin për pasurinë e lënë pas nga Konomi.

Në rubrikën “Shihemi në Gjyq”, me moderatoren Eni Çobani, familjarët kanë kërkuar të drejtën e tyre mbi pasurinë trashëgimore, ndërsa kanë rrëfyer edhe episode të rënda që, sipas tyre, kanë ndodhur pas vrasjes së Franc Konomit.

Xhoni, mes lotësh, tha se prej 17 vitesh jeton me dhimbjen e vrasjes së babait, ndërsa pretendoi se edhe ai vetë ka qenë në shënjestër dhe se ndaj tij janë kryer dy tentativa për vrasje.

Ai tregoi se ishte vetëm 15 vjeç kur babai u vra dhe se mungesa e tij ndikoi rëndë në jetën e tij. Sipas Xhoni, dhimbja ishte aq e madhe sa në një moment kishte menduar edhe t'i jepte fund jetës, por besimi te Zoti e kishte ndihmuar të vazhonte.

“Nuk po dal vetëm për të drejtën e vetes time, por edhe për të motrës sime. Po dal për një shkak që është prej 17 vitesh, një dhimbje që nuk e di asnjë njeri. Që mua ma kanë vranë babin prej 17 vitesh. Babi im quhej Franc Konomi, unë jam djali i Franc Konomit, që kurrë nuk kisha të drejtën për t'i thënë vetes që unë isha gjaku i atij. Pse?! Kur më vranë babin deshën që të më vrisnin edhe mua dy herë”, rrëfeu ai.

Xhoni tha se në momentet më të vështira kishte menduar edhe për vetëvrasje.

“Unë nuk e përballova dot atë dhimbje dhe doja që të vrisja veten. Desha që të mbyjsja veten me lloj-lloj mënyrash që ju nuk ia keni idenë. Por, nuk ka dashur Zoti që të më marrë. Kam dashur që të iki, sepse nuk e përballoja dot”, u shpreh ai.

Ai tregoi se ishte rritur kryesisht me gratë e familjes dhe se e kishte ndjerë fort mungesën e të atit gjatë viteve të rritjes.

“Unë jam rritur vetëm me femra në familjen time, nuk e kam pasur një burrë që të më tregonte se si të rruhesha apo të sillhesha. Iku që kur unë isha 15 vjeç, unë e shikoja babin vetëm gjashtë javë në verë, asnjë gjë”, tha Xhoni.

Në anën tjetër, bashkëshortja e Franc Konomit, Roven, foli për pasurinë që, sipas saj, kishte lënë pas i ndjeri. Ajo tha se Franci kishte lënë një shtëpi dhe një hotel, të cilin pretendon se e kishte ndërtuar ndër vite, ndërsa akuzoi kunatin e saj, Adi Konomi, se kishte marrë hotelin dhe më pas ia kishte shitur një personi tjetër.

Postimet e reja

Arsimi i fëmijëve, deri në 100 mijë lekë zbritje nga...

SEPTEMBER 14, 2026

Harry dhe Meghan tërheqin fëmijët nga...

SEPTEMBER 14, 2026

Zelensky paralajmëron Evropën: Mos harroni...

SEPTEMBER 14, 2026

Rrahën barbarisht një indian në Thiva,...

SEPTEMBER 14, 2026

Mos e humb

AKTUALITET | SEPTEMBER 14, 2026

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Vitin e kaluar lute në Shqipëri pagoi 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro shpenzime...

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe “problematikët”

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatrat të tërë me ndotje

Na ndiq

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

Rovena tregoi se për shitjen e hotelit kishte mësuar pasi ishte kthyer në Shqipëri. Sipas saj, ajo nuk arrinte të kuptonte se si një pronë që e konsideronte të bashkëshortit të saj mund të shitej nga një person tjetër.

“Franci ka lënë shtëpinë e tij, ka një hotel të cilin e ka ndërtuar gjithë këto vite, që kemi qenë në Gjermani. Unë mundoja që të investoja dhe të jepja një kontribut sa të mundja. Kur shkova që pija një kafe, mbaj mend që ne bëmë një piceri, pishinë, kemi pasur dhe dhoma ku vinin turistët. Pyeta se i kujt ishte ky hotel, më thanë ‘ka qenë i Franc Konomit, e ka marrë Adi Konomi dhe ia ka shitur një personi tjetër’”, deklaroi ajo.

Rovena ngriti pikëpyetje mbi mënyrën se si, sipas saj, ishte shitur prona.

“Si mund të shesësh ti një pronë që nuk është e juaja. Ai nuk ka kontribuar kurrë për shtëpinë, ka qenë Franc Konomi që i ka mbajtur, e di një Tiranë e tërë”, tha ajo.

Ajo foli edhe për automjetin me të cilin Franc Konomi u vra. Sipas Rovenës, pas ngjarjes policia i kishte kërkuar të merrte makinën, por ajo kishte refuzuar, pasi nuk dëshironte të mbante automjetin në të cilin kishte humbur jetën bashkëshorti i saj.

“Franci kishte lënë një ‘Benz’ në të cilin u vra dhe një ‘BMW’, më erdhi policia dhe më tha që t’i merrja. Unë të merrja një ‘Benz’ ku ka humbur jetën burri im, dua që të digjet ai ‘Benz’”, rrëfeu ajo.

Sipas saj, vetëm një javë më vonë ajo kishte parë vëllain e Francit duke përdorur të njëjtën makinë në Tiranë.

“Kur pas një jave shikoj vëllain e vet, e kishte larë makinën dhe lëvizte në mes të Tiranës. Të vritet vëllai jot dhe ti të hipësh te ajo makinë, ku ka dhënë shpirt?!” tha Rovena.

Si u vra Franc Konomi?

Franc Konomi u ekzekutua më 8 korrik 2010, pranë zonës së “Pazarit të Ri” në Tiranë. Ai u qëllua me 10 plumba dhe u gjet i pajetë brenda automjetit të tij, një “Mercedes-Benz” i zi.

Konomi ishte një prej emrave të njohur të botës kriminale të Tiranës së viteve ‘90 dhe konsiderohej si një nga personat e fundit të mbetur gjallë nga grupi i të rinjve që në atë periudhë njiheshin si “të fortët” e kryeqytetit.

Vrasja e tij mbeti për vite një prej ngjarjeve më të bujshme kriminale, ndërsa sot, 17 vite më pas, familjarët e tij kanë rikthyer në vëmendje jo vetëm ekzekutimin, por edhe pretendimet e tyre për pasurinë e lënë pas dhe ngjarjet që, sipas tyre, kanë ndodhur pas vrasjes.

Franc Konomi

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radar@me@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.